

Shehu  
Ale  
zy

1- Te selit publikimin  
a) tel web "Udhëzimet  
hiperene  
2- Te selit Udhëzimet  
a) tel docs e origjellit  
b) origjinalin  
c) origjinalin  
d) origjinalin




QENDRË KOMBËTARE  
E REGJISTRIMIT  
NR. 10147 Prot.  
Datë 11.7.2011

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
BERAT

NR.REGJ.THEMELTAR 1484/50 (01479)  
DATA E REGJISTRIMIT 01.10.2009

NR.VENDIMI s'ka  
DATA 18.02.2011



TARIFE E MARRË

« Në Emër të Republikës »

Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Berat e përbërë nga:

**Gjyqtari Eriol Roshi,**

Asistuar nga sekretarja e seancës gjyqësore Natasha Hasanbelliu sot në Berat, më dt. 18.02.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile nr. 1484/50, dt. 01.10.2009, që i përket:

**KËRKUES:** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.

**PERSONI I TRETË** Shoqëria "FABRI" SHPK.

**OBJEKTI:** Çelje e Procedurës së falimentit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 13/2, 14 e vijues të ligjit nr. 8901, dt. 23.05.2002 "Për falimentimin" ndryshuar me ligjin nr. 9919, dt. 19.05.2008, neni 104 i ligjit nr.

08-07-2011

9920, dt. 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"  
udhëzimi nr. 24, dt.02.09.2008 të Ministrisë së Financave.

Në përfundim të procedurës së falimentimit të kësaj shoqërie gjykata pasi  
dëgjoi administratorin e falimentimit Dhimo Dundo i cili deklaroi se ishte bërë  
shpërndarja e masës përfundimtare të falimentimit

### V Ë R E N

Se me vendimin nr. 2, dt. 11.01.2010 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka  
vendosur çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë me përgjegjësi të  
kufizuar me emërtimin "FABRI", me objekt të veprimtarisë tregtare Import –  
eksport., me seli në Komunë Otlak, rrethi Berat . Shoqëria mban NIPTI-n  
K633270160.

Në zbatim të ligjit për falimentimin nga administratori i falimentimit i  
caktuar nga gjykata me këtë vendim, janë kryer të gjitha procedurat ligjore të  
parashikuara nga ky ligj duke filluar nga evidentimi i masës së falimentimit,  
pretendime të kreditorëve, dhe shpërndarja përfundimtare e saj.

Po kështu me vendimin e datës 13.01.2011 gjykata ka vendosur të  
miratojë shpërndarjen përfundimtare të masës së falimentit duke përfshirë edhe  
shpërblimin e administratorit të falimentimit dhe duke caktuar seancën  
përfundimtare për në datë 18.02.2011.

Në seancën e sotme pasi nuk u paraqit ashtu si dhe gjatë gjithë  
procedurës së falimentimit asnjë kreditor , gjykata në zbatim të nenit 163 të ligjit  
nr. 8901, dt. 23.05.2002 "Për falimentin" i ndryshuar çmon se duhet të deklarojë  
të mbyllur procedurën e falimentimit për shkak të likuidimit total të aseteve të saj.

Në bazë të nenit 51 të ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, gjykata urdhëron  
çregjistrimin e kësaj shoqërie nga regjistri tregtar

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata pasi pa n. 306 e vijues të K.Pr.Civile

### VENDOSI

1. Mbyllet e procedurës së falimentimit për Shoqërinë "FABRI" SHPK me seli në Komunën Otlak , rrethi Berat me NIPT K633270160 .
2. Urdhërohet çregjistrimi i kësaj shoqërie nga regjistri tregtar.
3. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit .
4. Urdhërohet shpallja publike e vendimit dhe e shkakut të mbylljes, duke u dërguar një kopje për botim në buletin e njoftimeve publike në Agjensinë e Prokurimit Publik.

Në Berat sot më dt. 18.02.2011

Sekretare

Natasha Hasanbelliu



Gjyqtar

Eriol Roshi

